



BASHKIA FIER

Adresa : Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Shtetese"; Tel/Fax : 034 410 636; www.bashkiafier.gov.al

Nr. 1347/Prot.
6

Datë 05/05/2017

KONTRATE SIPERMARRJE- Nr. /231/2017 ME OBJEKT :

"RIKONSTRUKSION I UJESJELLESAVE TE NJESISE ADMINISTRATIVE CAKRAN"

Drejtuar : _____

PALET :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA FIER
- ❖ KONTRAKTOR : B.O HARMONIA SHPK & MANE/S SH.P.K FIER



KONTRATE SIPERMARRJE Nr. /231/2017

“Rikonstruksion i ujesjellesave te njesise administrative Cakran”

Lidhur sot, më 05/05/2017 midis Bashkise Fier, perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise z.Armando SUBASHI nga njera ane dhe bashkimit te perkohshem te shoqerive Harmonia shpk & Mane/S sh.p.k, me perfaqesues ligjor te tyre z.Stavri Prifti dhe z.Malo Mane nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PERKUFIZIME:

1. “Kontrate” do te thote Kontrate Siper marrje nr. /231/2017, me permbajtje dhe termat ne tekstin si me poshte. “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkëngjijtë dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
2. “Vlefte e Kontrates” eshte vlefte e plote ne leke perfshi TVSH e fituar ne tenderin e dates 20.03.2017 te organizuar ne Bashkine Fier per ndertimin e ketij Objekti.
3. “Objekt” do te thote “Rikonstruksion i ujesjellesave te njesise administrative Cakran Bashkia Fier, sipas Projektit te miratuar dhe Preventivit e Specifikimeve teknike te dhena e te pranuar ne tender.
4. “Autoriteti Kontraktor” eshte BASHKIA FIER.
5. “Kontraktor” eshte bashkimi i perkohshem te shoqerive Harmonia shpk & Mane/S sh.p.k , me numer NIPT J62903480D& J64103865K
6. “Preventiv” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje. Volumet dhe cmimet per secilin ze jane pjese e Ofertes Fituese dhe pjese e kesaj kontrate.
7. “Situacion Pjesor” do te thote situacioni per nje pjese te punimeve te preventivit, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituara ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH.
8. “Situacion Perfundimtar” do te thote situacioni per punimet e plota te percaktuara ne preventiv, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH, brenda vleres se fituar ne tender.
9. “Data e kryerjes se plote” do te thote data qe ndertimet duhet te mbarohen sic eshte shprehur ne grafikun per kryerjen e Ndertimeve.
10. “Kryerja” do te thote data e vertetuar se Ndertimet jane mbaruar.
11. “Defekt” do te thote cdo pjese e ndertimeve e perealizuar ne perputhje me specifikimet teknike te kontrates.
12. “Data e hyrjes” do te thote data qe Autoriteti Kontraktor lejon Kontraktorin ne Objekt dhe marrjen prej tij ne dorezim te Sheshit te Ndertimit me proces-verbal.
13. “Materiale” do te quhen te gjitha furnizimet duke perfshire edhe ato te konsumueshme, cilesia e te cilave vertetohet me certifikate, te perdorura nga Kontraktori per trupezimin e tyre ne ndertimin e objektit.
14. “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakter-stikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit
15. “Mbikqyres i punimeve” (Supervizori) do te thote subjekt fizik/juridik i licensuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate Mbikqyrje per ndertimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar, U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit” dhe paraqiten ne Kontraten e Mbikqyrjes.
16. “Kolaudatori” do te thote subjekt fizik/juridik i licensuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate per Kolaudimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar dhe paraqiten ne Kontraten e Kolaudimit.
17. “Ndertime” do te thote Projekti Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit, pjese perberese e Kontrates.
18. “Llogaritja e afateve” Te gjitha referencat e afateve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



19. "Afati i Garancise se Punimeve" do te thote periudha prej 24 muaj e cila fillon nga data e aktit te kolaudimit te punimeve, gjate te ciles Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt qe ka ardhur si pasoje e cilesise se punimeve te kryer prej tij.
20. "Garancia e Punimeve", eshte vlera prej 5% e vlefes se situacionit perfundimtar te miratuar.
21. "Baza ligjore" Kontrata do t'i nenshtrohet, do te qeveriset dhe do te interpretohet sipas ligjeve dhe dispozitave nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise, perfshire te gjitha dokumentat e tenderit dhe te ofertes se Kontraktorit te cilat jane pjese e kesaj kontrate sipas permbajtjes se tyre.
22. "Force Mdhore" do te thote nje ngjarje qe nuk mund te kontrollohet nga palet, ku perfshihen, por nuk jane te limitizuara, lufta, revolucionet, zjarri permbytja, termeti, epidemite, karantina, embargo tranziti, etj.

I. OBJEKTI I KONTRATES

"Rikonstruksion i ujesjellesave te njesise administrative Cakran Bashkia Fier, sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

II. VLEFTA DHE AFATI I KONTRATES


Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total sipas preventivit pa TVSH 26 463 616 lekë (njetzet e gjashte milion e katerqind e gjashtedhete e tremije e gjashteqind e gjashtembedhete) dhe me TVSH 31 756 339 leke (tridhjetete e nje milion e shtateqind e pesedhjetete e gjashte mije e treqind e tridhjetete e nente)) dhe afati i kryerjes se punimeve eshte 2 (dy) muaj.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vlefte totale te mesiperme perfshihet TVSH, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E AK

1. Te njohe zyrtarishi Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoje atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Fier do te vendoset nepermjet procedures se prokurimit, si perfaqesues prane sipermarresit, mbikqyresin e punimeve.
2. Te marre te gjitha masat pergatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoje Kontraktorin te hyje ne Objekt dhe ta dorezoje ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.
3. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. *Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.* (Neni 18 i KPK tek DST)
4. Brenda dates se hyrjes te siguroje te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoje kushte pune normale Kontraktorit.
5. Te miratoje situacionin pjesor dhe situacionin perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.
6. Te asistojte ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektivit.
7. Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektivit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtese mund te porositen vetem ne rrethana te percaktuar ne LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontrates te mos i kaloje 20% te cmimit original te kontrates.
8. Autoriteti Kontraktor ne cdo kohe, mund te porosise kontraktorin te beje ndryshime brenda qellimit te pergjithshem te kontrates ne secilin nga elementet e meposhtem (neni 36.3 i KPK ne DST):
 - a) Korrigjime ne projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
 - b) Korrigjime ne materiale
 - c) Korrigjime ne shprehjet e shprehjes
9. Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të paraqesin dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose të tjerë që është shkaktuar nga





ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marreveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

10. Te marre ne dorezim Objektivin pas kolaudimit perfundimtar.
11. Te vëri ne shfrytezim Objektivin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje certifikaten e garancise se punimeve.
12. Te verifikojë kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar flogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlefte e garancise se punimeve.
13. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a) kontraktori dështon në kryerjen e punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë;
 - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim të detyrimeve dhe kushteve të kontratës për një afat 15 ditë të plotë nga ato, me përjashtim të rasteve kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

IV. TE DREJTAT DHE DETYRAT E KONTRAKTORIT (SIPERMARRESIT)




1. Te siguroje Kontraten ne vleren 10% te vlefes totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.
2. Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes ne objekt deri ne Afatin e Mbarimit të punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 18(KVK) te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
3. Te marre ne dorezim Objektivin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.
4. Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektivit (*sheshit te ndertimit dhe lejes se ndertimit*) ne dorezim dhe emerimit te mbikqyresit te punimeve nga AK.
5. Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
6. Te caktojë drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender. te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoje zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.
7. Te njohe, te respektojë termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijojë kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.
8. Te realizojë Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundojë punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se 2 muaj.
9. Te pranojë cdo ndryshim jo thellesor te miratuar nga Investitori ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.
10. Gjate kryerjes se punimeve. te njoftoje ne kohe dhe zyrtarisht Investitorin per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Investitorit per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.
11. Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyt e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per flogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.
12. Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.
13. Te siguroje vete transportin, makinerite, fuqine puntore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitur ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. Nuk lejohet qe rolin e sipermarresit t'ia jape nje subjekt tjetër.



14. Te paraqese tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshm/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Situacionet te jene te miratuara edhe nga Mbikqyresi i Punimeve.
15. Te njoftoje me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektit. Ky njoftim duhet te behet jo me vonc se 5 (pese) dite para dates se perfundimit te punimeve.
16. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.
17. Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziquet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
18. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjitha dokumentacionin shkruesor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektit.

V. TE TJERA

1. Menyra e komunikimit midis paleve do te jete vetem me shkrim. Bashkia Fier ne baze te Kontrates se bashkepunimit dhe Prokures se Posacme te Bashkimit te Perkohshem te ketyre shoqerive njeh dhe mban kontakte me perfaqesuesin e autorizuar te ketij bashkimi, shoqerine "Harmonia" shpk Fier.
2. Secila anetare e ketij bashkimi te perkohshem shoqerish merr persiper te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet perpara Bashkise Fier si veç e veç ashtu edhe bashkerisht (detyrim solidar), si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes se tyre dhe çdo pergjegjesie tjeter te ligjshme qe do te rrjedhe nga kjo kontrate Sipermarrije, bazuar ne nenin 431 te Kodit Civil te R.SH.
3. Per çdo çeshtje qe lind gjate zhvillimit te punimeve, midis paleve kryhen negociata per zgjidhjen e tyre.
4. Ne qofte se Kontraktori braktis Objektivin pa e perfunduar ate, duke zgjidhur Kontraten ne menyre te njeanshme. Ai detyrohet te paguaj demin qe i shkakton Bashkise Fier dhe Garancine e Kontrates.
5. Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfunduara do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.
6. Palet nuk çlirohen nga çdo pergjegjesi per mos zbatimin e termave te kesaj e Kontrate, pervec se ne rast te veprimt te forcave madhore te vertetuara nga Institucionet Zyrtare.
7. Kontraktori, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori jane te detyruar te kontaktojne zyrtarisht me Specialistin e Investimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve Publike te Bashkise Fier, pasi ky i fundit do te jete personi i kontaktit i cili do te monitoroje gjithë procesin e zbatimit te punimeve, per kete objekt kontrate.
8. Per çdo dite vonese tej afatit te punimeve, Kontraktori eshte i detyruar t'i paguaj Investitorit, gjobe ne masen 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
9. Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligji. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.
10. Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerine "Harmonia" shpk, qe perfaqeson bashkimin e perkohshem ne Raiffeisen Bank nr. e llogarise Nr. ALLO300002250 dhe IBAN AL27 2022 1005 0000 0003 0000 2250.
11. Çdo mosmarveshje qe do te linde gjate zbatimit te kesaj Kontrate, palet do ti zgjidhin me mirekuptim, ne te kundert do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Fier.
12. Pjese perberese e kesaj Kontrate jane edhe Projekti i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit me cmime qe eshte paraqitur ne tender nga Sipermarrresi si dhe Specifikimet Teknike te punimeve te pranuar dhe Grafiku i Punimeve.
13. Certifikata e Garancise se Punimeve leshohet pas perfunimit te Afatit te Garancise qe eshte 24 muaj, pasi Kontraktori, Mbikqyresi, Kolaudatori dhe AK kane inspektuar Objektivin dhe kane konstatuar qe nuk ka difekte dhe punime te pakryera si dhe qe ai funksionon ne perputhje me Projektin.
14. Per difektet qe nuk janë ndrequr gjate Afatit te Garancise se punimeve te ndertimit, AK llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe gjate ndalesen nga vlera e Garancise se punimeve qe eshte ne vleres totale te Kontrates.
15. Çmimet e punimeve do te jene ato te situara ne tender, sipas preventivimit dhe Sipermarrjes.



16. Bashkia Fier mund te beje ne çdo kohe porosi tek Kontraktori per te bere ndryshime (specifikime teknike) brenda qellimit te pergjithshem te kontrates.
17. Kontraktori eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me KESH, ALBTELEKOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. A fati i njoftimit per keto subjekte do te jete 5 (pese) dite perpara kryerjes se punimeve.
18. Kjo Kontrate hartohet ne 6 kopje, 1 per Kontraktorin dhe 5 per Bashkine Fier dhe pasi lexohet nga palet. nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire ne Fier sot me date 25 / 05/2017.

Adresa :

Bashkia Fier, L. "Kastriot", Rr. "Brigada e XI Sulmuese"
www.bashkiafier.gov.al Fier

Adresa :

B.O: "Harmonia sh.p.k. & Mane/S sh.p.k"
 Lagjja Kastriot, Rr Leon Rei, pallati Harmonia, Fier

Për dhe në emër të :

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR
BASHKIA FIER

KONTRAKTORI
B.O: "HARMONIA SH.P.K. & MANE/S SH.P.K"

Armando SUBASHI




z.Stavri PRIFTI



z.Malo MANE

